



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 29.04.2015, me fillim në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla nr. N-302

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljevic, kryetar, Agim Qeku, nënkryetar i parë, Mufera Sinik, nënkryetare e dytë, Agim Kukaj, Rustem Berisha, Fisnik Ismajli, Jasmina Živković, Čerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi, anëtarë

Munguan: Milka Vuletić dhe Slavko Simić, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: vëzhguesi i OSBE-së dhe ai i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Nga stafi për përkrahje të Komisionit: koordinatoreja e Komisionit dhe zyrtarja për lëmin përkatës.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetar i Komisionit

Për mbledhje është propozuar ky,

R e n d i d i t ë s:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Caktimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e ligjeve sipas Planit të punës së Komisionit për vitin 2015 dhe**
- 3. Të ndryshme.**

1. **Kryetari** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje dhe hapi shqyrtimin për pikën e dytë:
2. **Caktimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e ligjeve sipas Planit të punës së Komisionit për vitin 2015**

Kryesuesi- shkurtimisht i informoi anëtarët e Komisionit për procesin e mbikëqyrjes së ligjeve nga legjislatura e mëparshme dhe i ftoi anëtarët e Komisionit që, në mënyrë aktive, të përfshihen në vazhdimin e procesit të mbikëqyrjes së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendren historike të Prizrenit, në kontinuitet për çështjet e përcaktimit të rregullave të mbrojtjes, udhëheqjes dhe zhvillimit bashkëkohor të fshatit Hoçë e Madhe, si pasuri e trashëgimisë kulturore e fetare, nën mbrojtjen e përhershme me statusin e zonës me mbrojtje të veçantë..

Gjithashtu, edhe për ligjet tjera për mbikëqyrjen e të cilave jemi përcaktuar sipas Planit të punës së Komisionit për vitin 2015, sot duhet formuar këto grupe si për: Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës (posaçërisht neni 11), Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin për Financat Lokale.

Sa i përket formimit të grupeve punuese për mbikëqyrjen e P/ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-047, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për financat lokale, këto grupe do të formohen më vonë, kur ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për promovimin e të drejtave të komuniteteve , të dërgohen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, kurse për Ligjin për financat lokale, pas përfundimit të trajnimit për deputetë, për çështjen e mbikëqyrjes së buxhetit që e organizon OSBE javën e ardhshme.

Pas konsultimeve të shkurtëra, Komisioni nxori këtë,

Përfundim për formimin e grupeve për mbikëqyrjen e ligjeve

1. Përbërja e grupeve të punës për mbikëqyrjen e **Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe** dhe për Qendrën historike të Prizrenit:

1. Jasmina Živković
2. Saša Milosavljević
3. Slavko Simić
4. Mufera Sinic dhe
5. Fisnik Ismaili

2..Përbërja e Grupit të punës për mbikëqyrjen e **Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës:**

1. Veton Berisha
2. Čerim Bajrami dhe
3. Milka Vuletić

3. Përbërja e Grupit të punës për mbikëqyrjen e **Ligjit për vetëqeverisjen lokale**:

1. Agim Kikaj
2. Danush Ademi dhe
3. Rustem Berisha

Kryesuesi, hapi shqyrtimin për pikën e tretë :

3. Të ndryshme

Agim Qeku e informoi Komisionin për marrëveshjet e arritura me homologun e Komisionit parlamentar për komunitetet pakicë të Republikës së Kroacisë dhe të Republikës së Malit të Zi, për realizimin e vizitave studimore të delegacionit të deputetëve të Komisionit, me qëllim të shkëmbimit të përvojave nga lëmi i zgjedhjes së të drejtave të komuniteteve pakicë dhe mbrojtjen e e interesave të tyre në Republikën e Kroacisë dhe në republikën e Malit të Zi.

Vizita në Republikën e Kroacisë do të realizohet në muajin qershor, kurse vizita në Republikën e Malit të Zi do të realizohet në muajin shtator. Përbërja e dy delegacioneve do të caktohet më vonë , kurse për renditjet tjera do të përkujdeset stafi për mbështetje punës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgaditur nga:

Njësia për komisionet parlamentare

Kryetari i Komisionit

Saša Milosavljević